

Përshkrimi i detyrave të punës

Pozita	Ekspert për monitorimin e Strategjisë Sektoriale të MPMS në lidhje me efektivitetin e MATP-ve për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian
Kodi i procedurës së rekrutimit	KOSINT-010
Emërtimi i projektit ose programit	KOSINT 2020
Kodi dhe emërtimi i aktivitetit	ZB KS2B601 Monitorimi i reformave sektoriale - Raportet tematike
#ditëve të punës	10
Periudha e angazhimit	20.03.2019 – 30.06.2019

Qëllimi i konsulencës

Qëllimi i kësaj konsulence është ofrimi i ekspertizës për monitorimin e procesit të zbatimit të Strategjisë Sektoriale të MPMS, dhe atë pjesën që ka të bëjë me efektivitetin e MATP-ve për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.


Përshkrimi i projektit/programit

Projekti KOSINT2020 është një partneritet mes katër organizatave të shoqërisë civile të angazhuara në gjithëpërfshirjen e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian në fushat e arsimit, punësimit dhe mirëqenies sociale. Financuar nga Roma Initiatives Office (RIO) në kuadër të Fondacionit për Shoqëri të Hapur (OSF), projekti synon të ngrisë kapacitetet e shoqërisë civile për monitorimin e reformave sektoriale, të sigurojë implementimin e duhur të tyre, dhe të ndikojë në hartimin e politikave në tri fushat e lartcekura sa u përket këtyre tri komuniteteve, duke marrë parasysh zotimet në Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali, Egjiptian në Shoqërinë Kosovare 2020.

Përshkrimi i hollësishëm i detyrave të punës

Qëllimi i angazhimit të ekspertit është hartimi i raportit tematik të monitorimit në fushën e punësimit i cili do të realizohet në kuadër të raporteve të përgjithshme të monitorimit/vlerësimit të progresit në fushën e arsimit dhe punësimit për vitin 2018. Angazhimi përfshin aktivitetet në vijim::

- Zhvillimi i planit të punës për hartimin e raportit tematik;
- Shqyrtimi i politikave nacionale dhe lokale për fushën e punësimit, përfshirë planet e tyre të veprimit si dhe kornizat ekzistuese të monitorimit;
- Shqyrtimi i dokumenteve të ndryshme/relevante në fushën e punësimit;

	PËRSHKRIM I DETYRAVE TË PUNËS		F-113
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 2 nga 2

- Përgatitja dhe udhëheqja e diskutimeve në grup/intervistave/pyetësorëve me qëllim të mbledhjes së të dhënave;
- Përpunimi i të dhënave të mbledhura;
- Hartimi i raportit tematik duke u bazuar në të gjeturat nga hulumtimi;
- Prezantimi i raportit.

Rezultatet e pritshme

- Hartohet metodologjia e hulumtimit;
- Mblidhen të dhënat sasiore dhe cilësore në lidhje me efektivitetin e MATP-ve për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
- Hartohen raporti tematik i cili përmban të dhëna sasiore dhe cilësore të cilat pasqyrojnë gjendjen reale të efektivitetit të MATP-ve për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
- Raporti përmban/ofron rekomandime për përmirësim;
- Të gjeturat nga raporti prezantohen dhe diskutohen me të gjitha palët në fushën e arsimit.

Kualifikimet

- Kualifikim i nivelit baçelor, preferohet niveli master, në fushën e shkencave sociale.
- Njohje e mirë e sistemit të punësimit në Kosovë.
- Përvojë pesëvjeçare në fushën e hulumtimeve, e sidomos me komunitet rom, ashkali dhe egjiptian.
- Përvojë konkrete me Strategjitë dhe Planet e Veprimit të hartuara nga MPMS.
- Njohje solide e softuerëve statistikorë.
- Njohje e shkëlqyeshme e gjuhës shqipe dhe angleze.

Raportimi

Konsulenti i raporton menaxheres së projektit, Jehona Xhaferi.

Dokumenti duhet të dorëzohet në formë elektronike (në formatin Ms Word, fonti Times New Roman, madhësia e fontit 12), në gjuhën shqipe apo angleze.